

**RIMËKËMBJA POST-COVID NË VENDBANIME JOFORMALE
NË RAJONIN E UNECE-S: PËRGJIGJE NDAJ EMERGJENCËS
DHE RINDËRTIM MË I MIRË**

Konteksti

Projekti “Rimëkëmbja post COVID-19 në vendbanimet joformale në rajonin e UNECE-s” forcoi kapacitetet e qeverive qendrore dhe vendore në vendet e UNECE-s për të adresuar nevojat e grupeve në nevojë që jetojnë në vendbanime joformale. Kjo kontribuoi në rritjen e rimëkëmbjes socio-ekonomike dhe urbane pas pandemisë në qytetet dhe vendet pjesëmarrëse.

Projekti rezultoi në zhvillimin e një Plani Veprimi për Rimëkëmbjen post COVID-19 për vendbanimet joformale për vendet në rajonin ECE, dhënien e rekomandimeve mbi përmirësimin e vendbanimeve joformale, si dhe në mbështetjen e rimëkëmbjes nga pandemia të katër qyteteve pilot: Tiranë (Shqipëri), Bishkek (Kirgistan), Podgoricë (Mal i Zi) dhe Shkup (Maqedoni e Veriut).



Objektivat e Projektit

Objektivat specifike të projektit ishin:

- i) Identifikimi i sfidave me të cilat përballen vendbanimet joformale në Tiranë (sidomos në zonën e Laprakës), Bishkek, Podgoricë, Shkup;
- ii) Vlerësimi i ndikimit dhe reagimeve ndaj pandemisë COVID-19, në vendbanimet joformale të përzgjedhura;
- iii) Përcaktimi i një procesi për hartimin dhe zbatimin e planeve/strategjive të rimëkëmbjes mbi adresimin e mangësive të identifikuara, përsheptimin e rimëkëmbjes dhe përmirësimin e rezistencës në afatgjatë;
- iv) Vlerësimi i nevojave të banorëve të vendbanimeve joformale të përzgjedhura nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së të dhënave;
- v) Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e vendbanimeve joformale dhe mbështetja e qyteteve në rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19.

Produktet

- Koordinimi i përgatitjes së një raporti vlerësimi dhe rekomandimeve për përmirësimin e vendbanimeve të përzgjedhura joformale, si dhe mbështetja e qytetit në rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19;
- Mbështetje teknike për hartimin e përmbledhjeve të politikave urbane mbi zhvillimin urban, përmirësimin e vendbanimeve joformale dhe rimëkëmbjen post COVID-19;
- Mbështetje teknike për organizimin e një webinarit rajonal për validimin e planeve të veprimit për katër qytete pilot.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:
Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE)

PARTNERËT:
• Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
• Bashkia Tiranë

KOHËZGJATJA:
09/2020 - 12/2020

KONTAKT:
Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri
M: +355694333808
E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.